



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 19/5 Prot.

Tiranë, më 20 .05.2016

V E N D I M

Nr. 53 , datë 20 .05.2016

Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë, (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr. 10/1 prot., dt. 13.01.2016.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak dhënë nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë, së procesit të ecurisë disiplinore, zhvilluar prej administratorit të Njesisë Administrative Farkë,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 10/1 prot., datë 13.01.2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së ndjekur në dhënien e masës disiplinore "vërejtje", ndaj disa punonjësve të Njesisë Administrative Farkë, nga ana e drejtuesit të kësaj njësie.

Nga dokumentacioni i mbledhur dhe administruar, rezulton se nga ana e drejtuesit të Njesisë Administrative Farkë, është marrë masa disiplinore "vërejtje", me aktet e mëposhtme, për disa punonjës:

Akti nr. 1183/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;
akti nr. 1186/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** ;
akti nr. 1187/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;
akti nr. 1179/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;

akti nr. 1185/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;
akti nr. 1181/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën ***** ;
akti nr. 1182/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën ***** ;
akti nr. 1180/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;
akti nr. 1176/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën ***** ;
akti nr. 1177/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën ***** ;
akti nr. 1178/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** ;

Motivi i dhënies së masës disiplinore ka qenë: *“Mosparaqitja në detyrë në kohën e caktuar”*. Rezulton se, punonjësit, pasi janë vënë në dijeni nga njësia e burimeve njerëzore për masën e marrë, kanë parashtruar papësimet përkatëse duke e kundërshtuar atë.

Më poshtë, paraqiten në mënyrë analitike, të dhënat për secilin punonjës, pozicioni i tyre si nëpunës civil, akti i emërimit për fillimin e marrëdhënies së punës, akti i deklarimit të statusit të punësimit në bazë të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe procedura e ndjekur për dhënien e masës disiplinore të kontestuar, sipas konstatimit të grupit të inspektimit:

1. Punonjësja ***** , është emëruar në pozicionin *“Juriste, në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*, në datën 01.05.2003. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kishte më shumë se një vit në këtë pozicion. Në të tilla kushte, me të drejtë, me shkresën nr. 2027/1 prot., dt. 22.09.2014, është deklaruar statusi i punësimit *“Nëpunëse Civile”*.

Me shkresën nr. 1081 prot., dt. 18.12.2015, *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”* , ndaj kësaj punonjëseje, ka filluar procedimi disiplinor. Motivacioni i masës disiplinore është *“Largim nga orari i punës në grup, jashtë lejes së dhënë, duke sjellë probleme në vazhdimin e procesit të punës dhe si pasojë , mungesën e shërbimit ndaj banorëve të zonës, pasi në datën 15.12.2015, arkiva nuk ka funksionuar”*.

Punonjësja ka marrë dijeni për këtë veprim administrativ, kundrejt nënshkrimit dhe menjëherë ka shprehur kundërshtimin e saj. Në vazhdim të procedurës, me shkresën e Administratorit të Njesisë nr. 1084/2 prot., dt. 24.12.2015, *“Për zbatim”*, për këtë punonjëse, është vendosur edhe heqja e ditës së punës për datën 15.12.2015.

Me shkresën nr. 1081/3 prot., dt. 29.12.2015, *“Kundërshtime në lidhje me njoftimet për fillimin dhe ecurinë e procedimit disiplinor”*, punonjësja ***** ka shprehur kundërshtimet e saj me shkrim, në lidhje me këtë ecuri disiplinore.

Ankesa e nëpunëses nuk është marrë parasysh nga Administratori i Njesisë, i cili me aktin nr. 1186/1 prot., dt. 31.12.2015 *“Vendim për marrjen e masës disiplinore”*, duke marrë atributet e prororit direkt, ka vendosur dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*.

2. Punonjësi ***** , është emëruar në pozicionin “*Specialist, në Sektorin e GIS Kadastër në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, në datën 01.03.2006. Me shkresën nr. 2240/1, dt. 08.10.2014, i është deklaruar statusi i punësimit si “*Nëpunës Civil*” në atë pozicion.

Edhe për këtë nëpunës, ka filluar procedimi disiplinor nga ana e Administratorit të Njesisë Farkë, materializuar kjo nëpërmjet shkresës nr. 1076 prot., dt. 18.12.2015, “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*” me të cilën është njoftuar arsyeja e fillimit të procedurës disiplinore, dhe motivacioni: “*Mos respektimi i orarit të punës duke mos u paraqitur në zyrë dhe si pasojë, në dt. 17.12.2015 të interesuarve nuk u është ofruar shërbimi i kërkuar*”. Në vazhdim të procedurës, me shkresën nr. 1076/2 prot., dt. 4.12.2015, “*Për zbatim*”, drejtuesi i njesisë ka urdhëruar heqjen e ditës së punës për datën 17.12.2015.

Me shkresën nr. 1083/3 prot., dt. 29.12.2015, “*Prapësime mbi njoftimin për fillimin e procedimit disiplinor*”, punonjësi ***** ka parashtruar arsyet për të cilat nuk bie dakord me procedimin e nisur.

Ankesa e punonjësit nuk është marrë parasysh nga Administratori i Njesisë, i cili duke marrë atributet e eprorit direkt, me aktin nr. 1187/1 prot., dt. 31.12.2015 “*Vendim për marrje mase disiplinore*”, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”.

3. Punonjësi ***** është emëruar në pozicionin “*Specialist, në Sektorin e GIS Kadastër në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, me Urdhrin nr. 25, dt. 25.07.2012, të Kryetarit të Komunës Farkë. Punonjësit në fjalë nuk i është deklaruar statusi i punësimit si “*Nëpunës Civil*”, pasi në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, nuk plotësonte kriterin arsimor për të qenë nëpunës civil, për shkak se ishte me arsim të mesëm.

Niveli arsimor, është një kërkesë specifike për pranimin në shërbimin civil, e përcaktuar në germën “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (të ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht se, një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë.

Për këtë arsye, bazuar në pikën 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*” (të ndryshuar), njësia e burimeve njerëzore, duhet të kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.

Sa më sipër, akti nr. 1185/1 prot., dt. 31.12.2015, “*Vendim për marrje mase disiplinore*” dhe të gjitha procedurat e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, ndaj këtij punonjësi, duke e trajtuar si nëpunës civil janë të pavlefshme. Për pasojë, njësia përgjegjëse duhet të vazhdojë procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.

4. Punonjësi ***** është emëruar nëpunës civil, në pozicionin “*Specialist, Pastrim Gjelbërimi, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike*”, me Urdhrin e Kryetarit të Komunës Farkë nr.567 prot., dt. 01.11.2014, pra pas fillimit të efekteve juridike të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Plotësimi i pozicionit të punës pjesë e shërbimit civil, me akt të thjeshtë emërimi, është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi, sipas neneve 22, 23, e vijues çdo

marrëdhënie punësimi, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet lidhur, duke respektuar procedurën e konkurrimit të hapur, apo sistemin e karrierës. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Në këto kushte, akti nr. 1179/1 prot., dt. 31.12.2015, "*Vendim për marrje mase disiplinore*" dhe të gjithë procedurat e kryera nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ndaj këtij punonjësi, duke e trajtuar pa të drejtë si nëpunës civil, janë absolutisht të pavlefshme.

Për pasojë, njësia përgjegjëse, duhet të ndërpresë marrëdhënien e punësimit të këtij punonjësi dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore.

5. Punonjësjë ***** është emëruar në pozicionin "*Specialist i pagave arkë dhe Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës dhe Tatim Taksave*", para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*" të ndryshuar dhe në momentin e fillimit të efekteve të tij, kishte më shumë se një vit në atë pozicion, prandaj me të drejtë me shkresën nr. 1944/1, dt.05.09.2014, i është deklaruar statusi i punësimit si "*Nëpunëse Civile*".

Me shkresën e Administratorit të Njesisë Farkë nr. 1082 prot., dt. 18.12.2015, "*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*", janë parashtruar arsyet e fillimit të ecurisë disiplinore dhe motivacioni: "*Largim nga orari i punës në grup, jashtë lejes së dhënë, duke sjellë probleme në vazhdimin e procesit të punës dhe si pasojë, njerëzit nuk janë shërbyer, pasi në datën 15.12.2015, zyra e Burimeve Njerëzore nuk ka funksionuar*".

Më tej, me shkresën nr. 1082/2 prot., dt. 24.12.2015, "*Për zbatim*", administratori ka urdhëruar heqjen e ditës së punës, për datën 15.12.2015 edhe për këtë punonjëse.

Me marrjen dijeni të fillimit të ecurisë disiplinore, me shkresën nr. 1082/3 prot., dt. 29.12.2015, "*Kundërshtime në lidhje me njoftimet për fillim dhe ecuri të procedimit disiplinor*", punonjësjë ka parashtruar kundërshtimet e saj.

Ankesa e punonjëses nuk është marrë parasysh nga Administratori i Njesisë, i cili duke marrë atributet e eprorit direkt, me aktin nr. 1181/1 prot., dt. 31.12.2015 "*Vendim për marrje mase disiplinore*", ka vendosur dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje*".

6. Punonjësjë ***** është emëruar në pozicionin "*Administrator Shoqëror, në Drejtorinë e Financës dhe Tatim Taksave*" në datën 08.05.2002, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe në momentin e fillimit të efekteve të tij, kishte me shumë se një vit pune në atë pozicion prandaj me të drejtë, me shkresën nr. 1563/1, dt.16.07.2014, njësia përgjegjëse ka deklaruar statusin e saj të punësimit "*Nëpunëse Civile*" në pozicionin "*Specialist, administrator shoqëror*".

Me shkresën e Administratorit të Njesisë nr. 1079 prot., dt. 18.12.2015, "*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*", janë parashtruar arsyet e fillimit të ecurisë disiplinore dhe motivacioni: "*Largim nga orari i punës në grup, jashtë lejes së dhënë, duke sjellë probleme në vazhdimin e procesit të punës dhe si pasojë, njerëzit nuk janë shërbyer, pasi në datën*

15.12.2015, zyra e ndihmës ekonomike, nuk ka funksionuar". Më tej, me shkresën nr. 1079/2 prot., dt. 24.12.2015, "Për zbatim", edhe për këtë punonjëse, administratori ka urdhëruar heqjen e ditës së punës, për datën 15.12.2015.

Pasi ka marrë dijeni për fillimin e ecurisë disiplinore, me shkresën nr. 1079/3 prot., dt.29.12.2015, "Ankesa në lidhje me njoftimet për fillim dhe ecuri të procedimit disiplinor", kjo punonjëse ka parashtruar arsyet për të cilat nuk ka qenë dakord me shkeljen e pretenduar nga Administratori i Njesisë Administrative.

Ankesa e nëpunëses nuk është marrë parasysh nga Administratori i Njesisë, i cili me aktin nr.1182/1 prot., dt. 30.12.2015, ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Vërejtje".

7. Punonjësja ***** është e punësuar në pozicionin "Përgjegjëse e Zyrës së Gjendjes Civile Farkë". Zyra e gjendjes civile, duke qenë "Njësi publike direkte shërbimi", në bazë të germës "dh", të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, nuk bën pjesë në shërbimin civil.

Me shkresën nr. 1080 prot., dt. 18.12.2015, "Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor", të Administratorit të Njesisë ka filluar procedimi disiplinor, ndaj kësaj punonjëseje ku janë parashikuar arsyet e fillimit të kësaj ecurie disiplinore dhe motivacionin "Largim nga orari i punës, në grup, jashtë lejes së dhënë, në datën 15.12.2015". Më tej, me aktin nr. 1190/1 prot., dt. 31.12.2015, "Vendim për marrje mase disiplinore", administratori duke marrë atributet e eprorit direkt, ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Vërejtje".

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se, kryerja e procedurave të parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil, ndaj një punonjësi që nuk është nëpunës civil, është një procedurë e pabazuar në ligj, prandaj si e tillë, nuk duhet të merret parasysh. Në rastin konkret duhej të ndiqeshin procedurat dhe afatet e përcaktuara në Kodin e Punës së RSH.

8. Punonjësja ***** është emëruar në pozicionin "Protokoll-Arkivë, në Zyrën e Administratës", në datën 01.11.1992. Njësia përgjegjëse, duke pasur një perceptim të gabuar mbi natyrën e këtij pozicioni, nuk e ka përfshirë pa të drejtë si pjesë të shërbimit civil e për këtë arsye, nuk ka bërë as deklarinimin e statusit të punësimit për këtë punonjëse.

Pozicioni i punës "Protokoll- Arkivë, në Zyrën e Administratës", është një pozicion që ushtron autoritet publik, që prodhon/ protokollon/ regjistron/ legalizon, dokumente e shkresa të ndryshme, që hyjnë e dalin zyrtarisht në institucion.

Bazuar në pikën 26, të Lidhjes nr. 3, të Vendimit nr. 142, dt. 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", ky pozicion përfshihet në shërbim civil. Për këtë arsye, qëndrimi i mbajtur nga njësia përgjegjëse është i pabazuar në ligj.

Ndërkaq, edhe për këtë punonjëse, ka filluar procedimi disiplinor me shkresën nr. 1083 prot., dt.18.12.2015, "Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor" dhe me shkresën nr. 1083/1 prot., dt. 21.12.2015 "Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore", të Administratorit të Njesisë, ku parashtrohen arsyet e fillimit të procedurës disiplinore, që kanë të bëjnë me: "Largim nga orari i

punës në grup, jashtë lejes së dhënë, duke sjellë probleme në vazhdimin e procesit të punës dhe si pasojë, të mos shërbimit të njerëzve. Kështu, në datën 15.12.2015, shërbimi arkiv/protokoll, nuk ka funksionuar”.

Më tej, me shkresën nr. 1083/2 prot., dt. 24.12.2015, “Për zbatim”, administratori ka urdhëruar heqjen e ditës së punës për datën 15.12.2015 edhe për këtë punonjëse.

Lidhur me sa më sipër, punonjësja, me shkresën nr. 1083/3 prot., dt. 29.12.2015, “Ankesa në lidhje me njoftimet për fillim dhe ecuri të procedimit disiplinor”, ka parashtruar arsyet për të cilat nuk ka qenë dakord me shkeljen e pretenduar në to.

Kjo ankesë nuk është marrë parasysh nga administratori, i cili me aktin nr. 1176/1 prot., dt. 31.12.2015, “Vendim për marrje mase disiplinore”, ka vendosur përfundimisht dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”.

9. Punonjësja ***** është emëruar në pozicionin “Specialist, në Zyrën e Informimit për Publikun”, në datën 01.10.2011 dhe pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me të drejtë, njësia përgjegjëse, me aktin nr. 2244/1, dt. 08.10.2014, ka bërë deklarimin e statusit të punësimit, si “Nëpunëse Civile”.

Edhe për këtë punonjëse, me shkresën nr. 1078 prot., dt. 18.12.2015, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, Administratori i Njesisë Farkë ka filluar procedimin disiplinor me motivacionin: “Largimi nga orari i punës në grup, jashtë lejes së dhënë, duke sjellë probleme në vazhdimin e procesit të punës dhe si pasojë, njerëzit nuk janë shërbyer, pasi në datën 15.12.2015 zyra e informacionit, nuk ka funksionuar”.

Në vazhdim, me shkresën nr. 1078/2 prot., dt. 24.12.2015, “Për zbatim”, të administratorit është vendosur edhe heqja e ditës së punës, për datën 15.12.2015.

Duke mos qenë dakord me këto veprime administrative, punonjësja, me shkresën nr. 1078/3 prot., dt. 29.12.2015, “Ankesë në lidhje me njoftimin për fillimin e ecurisë disiplinore”, ka parashtruar pretendimet e saj.

Ankesa e punonjësës nuk është marrë parasysh nga administratori, i cili me aktin nr. 1177/1 prot., dt. 31.12.2015, “Vendim për marrje mase disiplinore”, duke marrë atributet e eprorit direkt, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”.

10. Punonjësi ***** është nëpunës civil i konfirmuar me aktin nr. 3, datë 01.03.2002, në pozicionin “Specialist për Urbanistikën” në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit pranë Këshillit të Qarkut Tiranë. Pas ristrukturimit të institucionit, vendi i tij i punës është shkurtuar dhe për këtë shkak, ai është transferuar në Komunën Farkë, aktualisht Njësia Administrative Farkë, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, me aktin nr.137/1, datë 16.01.2015.

Me Urdhrin nr. 13, datë 06.03.2015 ai është emëruar (i komanduar) në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, ku vazhdon akoma.

Me mbarimin e “komandimit (transferimit)”, nëpunësi duhet të ishte kthyer në detyrën e tij, si “Specialist në Zyrën e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”.

Ndërkaq, me shkresën nr. 1075 prot., dt. 18.12.2015, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor” të Administratorit të Njesisë, ka filluar procedimi disiplinor, me motivacionin: “Largim pa leje nga orari i punës në datën 14.12.2015”. Në vazhdim të procedurës, me shkresën nr. 1075/2 prot., dt. 24.12.2015, “Për zbatim”, për këtë punonjës është urdhëruar heqja e ditës së punës, për datën 14.12.2015. Pas komunikimit të aktit të fillimit të ecurisë disiplinore, me shkresën nr. 1075/3 prot., dt. 29.12.2015, “Prapësime mbi njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, punonjësi ***** ka paraqitur kundërshtimet e veta duke parashtruar dhe arsyet.

Ankesa e punonjësit nuk është marrë parasysh nga Administratori i cili duke marrë atributet e eprorit direkt, me aktin nr. 1178/1 prot., dt. 31.12.2015 “Vendim për marrje mase disiplinore”, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj tij.

11. Punonjësi ***** është emëruar në pozicionin “Nëndrejtor, në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, në datën 01.10.2011. Me aktin nr. 2242/1 prot., dt.08.10.2014, duke qenë se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” kishte më shumë se një vit në punë, me të drejtë njësia përgjegjëse, ka bërë deklarinë e statusit të punësimit si “Nëpunës Civil” në pozicionin “Specialist arkitekt”, pranë Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Edhe për këtë punonjës, me shkresën nr. 1085 prot., dt.18.12.2015, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, të Administratorit të Njesisë, ka filluar ecuria disiplinore, duke parashtruar arsyet e fillimit të kësaj ecurie dhe motivacionin: “Mosrespektim i orarit të punës dhe rregullave të brendshme të njesisë administrative të firmosura edhe në kontratën e punës, duke hyrë me forcë në institucion”.

Për shkresën e mësipërme, punonjësi është njoftuar kundrejt nënshkrimit, duke shënuar me këtë rast prapësimin e tij, se nuk bie dakord me shkeljen e përshkruar në njoftim. Në vazhdim të procedurës, me shkresën e Administratorit nr. 1085/2 prot., dt. 24.12.2015, “Për zbatim”, për këtë punonjës, është vendosur heqja e një dite pune, pa përcaktuar datën.

Ankesa e punonjësit nuk është marrë parasysh nga Administratori i Njesisë, i cili me aktin nr.1183/1 prot., dt. 31.12.2015, “Vendim për marrje mase disiplinore”, duke marrë atributet e eprorit direkt, ka vendosur dhënien ndaj tij të masës disiplinore “Vërejtje”.

*

* *

Në të njëjtën kohë me rastet e mësipërme, administratori i Njesisë Farkë, i ka propozuar Kryetarit të Bashkisë, fillimin e ecurisë për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje me

paralajmërim për shkarkim nga detyra”, për punonjësit, ***** me detyrë “*Përgjegjës i Zyrës Juridike dhe Mbrojtjes së Tokës*” dhe ***** me detyrë “*Specialist i Zyrës së Kadastrës dhe Mbrojtjes së Tokës*”.

1. Punonjësi ***** është nëpunës civil në pozicionin “*Specialist, në zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, i emëruar me Urdhrin nr. 9, dt. 03.07.2007, të Kryetarit të Komunës Farkë. Me të drejtë, me shkresën nr. 2121/1 prot., dt. 26.09.2014, njësia përgjegjëse ka deklaruar statusin e tij të punësimit si “*Nëpunës Civil*”.

Në lidhje me këtë punonjës, Administratori i Njesisë, me shkresën nr. 855 prot., dt. 23.11.2015, “*Propozim për dhënie mase disiplinore*”, i ka propozuar Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurës për dhënie e masës disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra*” me motivacionin: “*...ka thyer disiplinën formale dhe administrative në punë...*”.

Më pas rezulton se, me shkresën nr. 867 prot., dt. 23.11.2015, “*Propozim për emërim në detyrë*”, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Tiranë, është propozuar që punonjësi ***** të emërohej në pozicionin “*Specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, pozicion të cilin e mbante punonjësi ***** (emërim i cili nuk është vënë në zbatim, pasi nuk është miratuar nga Bashkia Tiranë, që është autoriteti kompetent për të bërë emërimet dhe transferimet që lindin të nevojshme, gjatë administrimit të përditshëm, sqaruar kjo, edhe në procesverbalin e mbajtur ditën e inspeksionit, e që është pjesë e dosjes në këtë rast).

Më tej, Administratori me shkresën nr. 959/2 prot., dt. 04.12.2015, “*Kërkesë për kopje dokumentacioni*”, drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Njesisë Administrative Farkë, ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit që përmban dosja e personelit për punonjësin ***** dhe më pas, me shkresën nr. 959/3 prot., dt. 10.12.2015, “*Dërgim dokumentacioni*”, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkisë Tiranë, i ka dërguar dokumentet e dosjes, në Bashkinë Tiranë.

Nga aktet e vëna në dispozicion, rezulton se, Bashkia Tiranë, nuk ka kthyer ende përgjigje, në lidhje me kërkesën e Administratorit të Njesisë Administrative Farkë, për zëvendësimin e punonjësit ***** .

Me marrjen e njoftimit sa më sipër, punonjësi ***** ka paraqitur ankesë drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ku ka parashtruar edhe pretendimet e tij, në lidhje me propozimin e bërë për ecuri disiplinore, e cila nuk është finalizuar me një masë konkrete.

2. Punonjësi ***** është emëruar në pozicionin “*Drejtore, në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, me Urdhrin nr. 7, dt. 17.03.2009, të Kryetarit të Komunës Farkë. Aktualisht mban pozicionin, “*Përgjegjës, në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, referuar vendimit nr. 27, datë 13.08.2015 “*Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të Njësive Administrative të Tiranës*”, si dhe Lidhja nr. 3 “*Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 000 deri 20 000 banorë*”, ku parashikohet vetëm

emërtesa Përgjegjës dhe jo Drejtor . Me shkresën nr. 2052/1 prot., dt. 22.09.2014, është deklaruar statusi i punësimit si “Nëpunës Civil”, në pozicionin “Drejtor, në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”.

Edhe për këtë punonjës, Administratori i Njesisë, me shkresën nr. 856 prot., dt.23.11.2015, “Propozim për dhënie mase disiplinore”, i ka propozuar Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” me motivacionin, “...ka thyer disiplinën formale dhe administrative në punë...”.

Po në të njëjtën datë, me shkresën nr. 868 prot., datë 23.11.2015, “Propozim për emërim në detyrë”, Administratori i Njesisë i është drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Tiranë, duke propozuar që punonjësja ***** të emërohej në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës Juridike dhe Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës”, (emërim i cili, gjithashtu, nuk është vënë në zbatim, pasi nuk është miratuar akoma nga Bashkia Tiranë, që është autoriteti kompetent për të bërë emërimet dhe transferimet që lindin të nevojshme gjatë administrimit të përditshëm, sqaruar kjo, edhe në procesverbalin mbajtur ditën e inspektimit, e që është pjesë e dokumentacionit të administruar në dosje).

Më tej, Administratori me shkresën nr. 959 prot., dt. 04.12.2015, “Kërkesë për kopje dokumentacioni”, drejtuar zyrës së Burimeve Njerëzore, të Njesisë Administrative Farkë, ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit që përmban dosja e personelit për punonjësën ***** . Me shkresën nr. 959/3 prot., dt. 10.12.2015 “Dërgim dokumentacioni”, aktet përkatëse janë dorëzuar pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Tiranë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, Bashkia e Tiranës, nuk ka kthyer ende përgjigje në lidhje me kërkesën e Administratorit të Njesisë Administrative Farkë, për zëvendësimin e punonjësit ***** .

Me marrjen e njoftimit sa më sipër, punonjësi ***** ka paraqitur ankesë drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ku ka parashtruar edhe pretendimet e tij, në lidhje me propozimin e bërë për ecuri disiplinore.

Duke analizuar veprimet e administratorit të Njesisë Administrative Farkë, për këto dy raste për të cilat ai ka propozuar fillimin e ecurisë disiplinore para Kryetarit të Bashkisë, i cili është organi që ka atributet e eprorit direkt, vërehet se ato janë veprime brenda kompetencave që i njeh ligji. Si drejtues i njesisë administrative, dhe si personi që kujdeset për disiplinën dhe mbarëvajtjen e punëve në njësinë që drejton, ai ka të drejtën të propozojë fillimin e procedimit disiplinor, në ato raste kur vlerëson se ka pasur thyerje të disiplinës, apo veprime që vijnë në kundërshtim me kryerjen e rregullt të detyrës.

Në këto kushte, aktet nr. 855 dhe 856 prot., dt. 23.11.2015, “Propozim për dhënie mase disiplinore”, vlerësohen të nxjerra në përputhje me kompetencën e administratorit dhe është e drejta e Kryetarit të Bashkisë të japë vlerësimin përfundimtar si epror direkt, nëse ka vend ose jo për të marrë masë disiplinore, ndaj punonjësve për të cilët është propozuar ecuri disiplinore.

*

* *

Në këto rrethana, duke u bazuar në analizën e dokumenteve të administruara në dosje, të cilat u përshkruan dhe shtjelluan më sipër dhe në përmbajtjen e germës, “a”, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe pikës 10, Kreu II, të Vendimit nr. 115, dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor”, në të cilën thuhet: “...në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore...”, është konstatuar se në gjithë këto raste, Administratori i Njësisë Farkë, ka marrë pa të drejtë, atributet e eprorit direkt në zhvillimin e ecurive disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore të mësipërme. Kjo kompetencë që ka përdorur zyrtari në këtë rast, nuk përfshihet në detyrat e përcaktuara në nenin 42/2, të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Duke analizuar sa më sipër, lidhur me veprimet administrative dhe aktet e nxjerra në përfundim të tyre, rezulton se kemi të bëjmë me dy probleme që duhet të gjejnë zgjidhje:

Së pari, a ka mundësi ligjore që Administratori të paraqitet me cilësinë e eprorit direkt, në kuptimin që i jep atij, germa “e”, e nenit 4 dhe pika 1, e nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar?

Së dyti, a mund të konsiderohen të vlefshme aktet për dhënien e masës disiplinore, kur në të aplikohen masa administrative që nuk parashikohen në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të tilla si, “Ndërprerja e pagës për ditë të caktuara pune”, “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, etj.

Në përgjigjen e çështjes së parë, mbahet parasysh fakti që, me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe atë nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me cilësinë e eprorit direkt për gjithë punonjësit e Njësisë Administrative, paraqitet Kryetari i Bashkisë. Për këtë arsye, është në kompetencën e këtij të fundit, fillimi dhe zhvillimi i ecurive disiplinore apo aplikimi i masave të caktuara disiplinore. Si rrjedhojë, drejtuesi i njësisë administrative, nuk mund të marrë përsipër e të kryejë funksione apo veprime, të cilat janë kompetencë e Kryetarit të Bashkisë.

Kjo del qartë nga përmbajtja e nenit 44/2, të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ndryshuar me ligjin nr. 9208 dt. 18.3.2004 dhe nr. 30/2015, dt. 2.4.2015), ku përmenden shprehimisht detyrat e administratës së njësisë administrative, në të cilat, nuk përfshihet paraqitja e Administratorit të Njësisë, si epror direkt për nëpunësit civilë që janë pjesë e administratës së Kryetarit të Bashkisë.

Në këto rrethana, pavarësisht, se në rastin konkret të dhënies së masës disiplinore, për punonjësit e sipërpërmendur, janë bërë përpjekje për respektimin nga pikëpamja formale të procedurës së parashikuar nga nenet 59 dhe 60, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ndodhemi në kushtet e kapërcimit të kompetencës nga ana e drejtuesit të njësisë administrative. Shkelja e kësaj kompetence (e cila i takon vetëm Kryetarit të Bashkisë) apo veprimi, pa pasur delegim kompetence, në bazë të nenit 116, pika "b", të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", bën që gjithë aktet e dhënies së masave disiplinore, për punonjësit e sipërpërmendur, të jenë akte absolutisht të pavlefshme.

Për më tepër, duke i dhënë përgjigje dhe çështjes së dytë të ngritur më sipër, aplikimi i masave disiplinore që nuk përfshihen në llojet e masave disiplinore që mund të aplikohen sipas nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të tilla si, "Ndërprerja e pagës për ditë të caktuar pune", "Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra", apo "Propozim për emërim në detyrë", përbën një aspekt tjetër të kundërligjshmërisë së akteve të dhëna për punonjësit e trajtuar më sipër.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në nenin 16 dhe 34, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- I. Të kërkojë nga Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, të drejtojë procesin e revokimit të akteve administrative për dhënie mase disiplinore, të dhëna nga Administratori i Njësisë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, si akte absolutisht të pavlefshme, sipas renditjes së mëposhtme:
 1. Akti nr. 1183/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "Vërejtje";
 2. Akti nr. 1186/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "vërejtje";
 3. Akti nr. 1187/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "Vërejtje";
 4. Akti nr. 1179/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "Vërejtje";
 5. Akti nr. 1185/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "Vërejtje";
 6. Akti nr. 1181/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore "Vërejtje";

7. Akti nr. 1182/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
 8. Akti nr. 1180/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
 9. Akti nr. 1176/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
 10. Akti nr. 1177/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësen ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
 11. Akti nr. 1178/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin ***** me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
- II. Njësia përgjegjëse, të drejtojë realizimin e procesit të fshirjes së shënimeve të mundshme që janë bërë në dosjet personale të nëpunësve dhe në regjistrin e personelit, për masat e mësipërme disiplinore.
 - III. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.
 - IV. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimit.
 - V. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe nëpunësit e Njesisë Administrative Farkë, të cilët janë përfshirë në këtë proces.
 - VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA